

DARDANIA E VJETËR DHE KOSOVA

Brahim AVDYLI¹

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim të përmbledhur, sidomos nga artikujt *“Edhe njëherë për Shqiponjën e Shqiptarët”*, pjesa e IV dhe V, si dhe disa të tjerë, për termat Dardania Ilire, Kosova e Fushë-Kosova, të cilat e bëjnë shpjegimin e qartë të këtyre termave, ne po përpikemi të japim provën e shpjegimit tonë. Nuk do mend se do të përballemi gjatë shpjegimit shkencor me përpjekjen e atyre që, sikur me *“detyrim”*, i shtrembërojnë shkencat, edhe historinë tonë, *disa shekuj përpara*, dhe na lidhin së prapiti me *“termat”* e shpikur të tyre. Në fakt, na lidhin ata të cilët kanë humbur në betejën e Fushë-Kosovës dhe qenë një bashkim i atyre që erdhën në këtë fushbetejë, kundër Turqisë otomane. Pjesën kryesore të tyre e përbënin vetë shqiptarët. Humbësi i vërtetë lidhet me gjërat që nuk janë aspak për të mbuluar ndjenjën e humbësit. Shtresat e poshtme të shoqërisë, shërbyesit e saj, të nënshtruarit në shoqëri, të cilët janë quajtur servët, shërbyesit e shërbëtorët, *“të lidhin”* nëpër qindra gënjeshtër, bashkë me gënjeshtarë të tjerë, nëpër Botë dhe Europë, dhe bëjnë çmos për të na imponuar një *“emër tjetër”*, apo për t’u dukur vetë më *“superior”*, deri në shpërfilljen tonë si komb. Nuk do mund më shumë të dihet se përse e marrin në vend të Shqiponjës *“sorrën shkinë”*-siç thuhet në popullin shqiptar për mëllenjat e zeza e qyqare (*të cilat nuk hahen dhe janë dëmtuese, në të mbjellurat me misër*), *“serbët”*, apo servët, e identifikojnë Fushë-Kosovën me *“fitoren”* që asnjëherë nuk e kanë pasur, e cila është fushë e mëllenjave dhe nuk e paraqet tërësisht Kosovën. Rajonin e Dukagjinit dhe Lekë Dukagjinit nuk i harrojmë. Kanuni i tij mbahet në mendje, për të gjithë shqiptarët dhe për tërë Kosovën.

Fjalë kyçe: yjet, alfabeti diellor, alfabeti kozmik, Dardani, Kosova.

HYRJE

Fanula Papazoglu, e cila tregon se: *“Dardania duhet të konsiderohet si zonë onomastike e veçantë. Fakti se emrat ilirë gjenden në tërë territorin e Dardanisë dhe se numri i tyre është mjaft i madh dhe të dëshmuar në Dardani, tregon se onomastika ilire në Dardani ka qenë autoktone...”*² Për mendimin tonë, emri dardan vjen prej dy fjalëve: dard+anë (*dard=shiqjetë dhe an=anë*). Kjo gjë na i shpjegon: shigjetat e Zotit, Krijuesit, vetëtimat e Zeusit, etj.

1. DARDANIA E VJETËR DHE KOSOVA

Po e shfletojnë së pari Dadaninë iliro-albane me historinë e lashtësisë dhe gjuhën mëmë gjuhën shqipe (*e cila është përdorur për herë të parë në historinë njerëzore*); hipotezën e alfabetit të parë, të quajtur “Alfabeti Diellor”, të cilin e ka filluar ta realizojë Xhemal Gashi, të marrur prej profilit të Besir Bajramit.

Ka edhe disa të tjerë të cilët e quanë pa e gjykuar më thellë, p.sh. “Alfabeti Kozmik”, por ky alfabeti nuk flitet në tokë dhe aq më pak nëpër hapësirën kozmike, pra “gjuha e njerëzve”. Sa të mundemi po e shqyrtojmë këtë temë, sikurse iliro-dardanët dhe prejardhjen e tyre. Shqiptarët, ilirët, apo yllirët dhe dardanët, e kanë e respektuar në radhë të parë prejardhjen e tyre prej yjeve në tokë, dhe e posaçërisht e kanë nderuar yllin më të vogël afër tokës, Diellin, si Zot të madh e të fuqishëm. Dardanët kanë pasur respekt të pazëvendësueshëm për Krijuesin e kësaj bote. Yjet janë udhëheqësit tanë, prijësit tanë, në tokë e në det, në hapësirën e tokës dhe hapësirën e paskaj të qiellit. Gjuha e parë në botë ka qenë gjuha mëmë, të cilën e

¹ Studiues etnolog, gjuhëtar dhe historian.

² Shikoni në veprën e Zef Mirditës, *„Studime Dadane”*, Shtëpia Botuese „8 Nëntori”, Tiranë 1982, sipas F. Papazoglu, ZEF VIII-1 (1964), 73, në faqen 29.

kanë folur ata që e besonin Zotin në krijimin e kësaj bote. Më së pari erdhi fjala, pra *“çdo fillim ka të bëjë me vetë fjalën. Në bibël shkruhet se fjala është e para...”*³ dhe kjo gjuhë që e kanë folur është për fjalën shqipe, në zanafillë, për gjuhën shqipe, prej të cilës kanë dalur të gjitha gjuhët e tjera.⁴ Problemi më i madh i joni, i cili shtohet si problem më emergjent, është të shpjegojmë se përse gjuha e jonë, gjuha shqipe, është gjuha “mëmë”, prej të cilës kanë dalur të gjitha gjuhët e tjera të botës dhe duhet të tregojmë se kjo gjuhë është e lindur me *“vullnetin e Zotit”*, por ai *“e fshehu të vërtetën”* dhe *“unifikimi i Trinisë së Shenjtë”*, e nxjerrur nga Bibla, që thuhet se është *“vepër e Zotit”*,⁵ por që është e shpikur nga njeriu i tokës, i cili ka qenë iliri i ynë, pra iliro-pellazgë, në të cilën shpjegohet krijimi i botës.

Po ky njeri i yni, siç thotë M. Gimbutas, ka krijuar shkrimin simbolik, afërsisht në vitet 5300-5200 p.e.s., d.m.th. rreth 200 vjet më përpara se sa të shkrimit sumer⁶, i cili është në mbështetje të shkrimit simbolik nëpër tërë Europën e në Gadishullin Ilirik. Ilirët, veçanërisht dardanët, qoftë atyre më të vjetër apo më të hershëm, për çka na e dëshmojnë studimet tona dhe studimet e legjendave, tregojnë se dardanët dhe ilirët i kanë stërgjyshërit e vet mbi Maqedoni, në trojet e Shqipërisë, Kosovës, e pjesërisht të Serbisë, deri mbi Nish, e cila është Mbretëria e Dardanisë. Trekëndëshin e krijimit të gjuhës shqipe e japin gjithsesi tri qendrat e Gadishullit Ilirik, që lidhen me njëra tjetrën, në trekëndëshin Nish-Sofje-Shkup. Dardania ishte një nga fiset më të mëdha e më të rëndësishme të ilirëve. Karakteristikat ilire dhe etnosi i vendbanimeve ilire, sikurse onomastika e saj, na dëshmojnë për banimin e përhershëm të dardanëve. Ne po e marrim me të drejtë një të dhënë të shkencëtares maqedonase, Fanula Papazoglu, e cila tregon se: *“Dardania duhet të konsiderohet si zonë onomastike e veçantë. Fakti se emrat ilirë gjenden në tërë territorin e Dardanisë dhe se numri i tyre është mjaft i madh dhe të dëshmuar në Dardani, tregon se onomastika ilire në Dardani ka qenë autoktone...”*⁷

Për mendimin tonë, emri dardan vjen prej dy fjalëve: dard+anë (*dard=shigjetë dhe an=anë*). Kjo gjë na i shpjegon: shigjetat e Zotit, Krijuesit, vetëtimat e Zeusit, etj. Në radhë të parë na e tregojnë anën në të cilin jetonin dardanët. Për ta dokumentuar këtë çështje po i marrim për shembull dy emërtimet e tjera: njëra “shkodran” e tjetra “lezhian”, e cila është ana ku jetojnë ata, shpjegon anën ku jetojnë, në Shkodër apo në Lezhë. Meqë Mbretëria e Dardanisë nuk na e ka lënë dhe as nuk e njohim kultin e “dardhës”, si e thonë pjesa dërmuese e shkencëtareve, besojmë se shigjeta ishte dard. Kjo ishte simbolikë e Zotit, krijuesit, personifikim i orakullit, prej të cilit rrjedhë Dardania, nga dard-shigjeta.⁸ Arma e parë e njeriut në tokë ishte shigjeta, në shembull të “armëve” që kishte krijuesi hyjnor, vetëtimës. Në shembull të shpejtësisë së “armëve” të Zotit e vetëtimës, njeriu e shpiki shigjetën. Ky ishte iliri dardan. Me vonë, kur zbulohen metalet, Romakët flasin për “Metalla Ulpiana” e “Metalla Dardanica”, etj. të cilat i shpjegojnë këto të dhëna.⁹

Një ndër qendrat më të lashta të Dardanisë dhe qendra e vetme minerale në Europë, ka qenë miniera Damnastium (jo Demastil), në Dardadinë e lashtë.¹⁰ Damasti ka qenë në Kosovën e sotme, në rrezë të Bjeshkëve të Sharrit, jo në territorin e Greqisë, dhe ka mbetur deri më sot e pazbuluar. Vetë Apolloni ishte hiperboreanë dhe vinte nga trevat e Sharrit, nga Dellosi i Boreasit, rrethi i Prizrenit, e jo nga ishulli i Dellosit,

³ Shikoni po deshët librin Kastriot Melyshit, *“Shqipja dhe e vërteta Biblike”*, GEER, Tiranë 2014, faqe 20.

⁴ Shikoni provën e parë, sepse ka edhe të tjera, librin e Fredi Balajt, *“Gjuha që bota e flet dhe simbolika e germave”*, FRAL 2000, Tiranë 2017.

⁵ Vepra e Kastriot Melyshit, e cekur më lartë, faqe 8.

⁶ Shikoni shkrimin e vënë në *“Kosovas Arkeologie”*, të datës 12 dhjetor 2018, *“Misteret e Dardanisë antike <<Dardania e pazbuluar>>, historia antike shqiptare”*, në <http://www.facebook.com/Kosovas> Arkeologie.

⁷ Shikoni në veprën e Zef Mirditës, *“Studime Dadane”*, Shtëpia Botuese „8 Nëntori”, Tiranë 1982, sipas F. Papazoglu, ZEF VIII-1 (1964), 73, në faqen 29.

⁸ Shikoni në *“Kosovas Arkeologie”*, më tutje.

⁹ Po aty, më tutje.

¹⁰ Shikoni në veprën historike të Prof. Dr. Eqrem M. Zemelaj, *“Pelazgët, ilirët, shqiptarët/Historiografia e lashtësisë dhe vazhdimësisë së një populli pro selenë-Burime arkivore të vendeve të huaja”*, Botimet Artini, Prishtinë 2017, faqe 339-340.

pjesë e ishujve kiklade.¹¹ Dardania, e cila ishte superfuqi metalurgjike, përfshinte një bashkësi të tërë nënfishesh, të cilat e mbanin tërë Gadishullin Ilirik dhe Euro-Azinë, dhe ka lëvizur në drejtim të Lindjes e Perëndimit, të Jugut e Veriut.

Gegët dhe gigantët kanë qenë të parët, por bashkë me etruskët e toskët. Gadishulli Ilirik dhe Dardania kanë qenë qendra e përhapjes së tyre nëpër Europë dhe nëpër Botë. Për të ilustruar këtë fuqi të mistershme e të vjetër të Dardanisë, e cila na shprehet “pa libra”, vetëm me simbole, të cilat mund të njihnin këtë gjuhë speciale vetëm përmes besimit dhe intuicionit, bashkë me këtë, edhe të gjuhës sonë arbërore, ne po e sjellim një fakt thelbësor se romakët, përtej detit Adriatik, pra në Gadishullin Ilirik, për të pushtuar edhe botën, vinin dhe kalonin krahun lindor të Adriatikut, për të marrë mineralet që kishin nevojë për derdhjen e armëve të veta pushtuese. Si thuhet zakonisht, njeriu farkëtar ishte dardano-ilir dhe dëshmonte lidhjen me Zotin, të cilët, si sot, e mbanin Plisin e Badhë apo Qeleshen (Qylafin) dhe ishte “njeriu i ditur i të diturve”, besimtarë apo adhurues i Zotit, Krijuesit të kësaj bote. Kjo gjë e forcon bindjen tonë, të mbështetur në shkrimet shkencore, se të gjitha lëvizjet e popullatave nuk kanë ardhur nga Lindja në Europë, por nga Europa në Lindje dhe nga Dardania, nëpërmes të Kaonisë (Epirit), territori i dytë, të cilat e kanë mbajtur gjallë Shqipërinë.¹² Pra Dardania lartë dhe Epiri poshtë e mbajnë si dy krahët e shqiponjës shqipen, Shqipërinë. E konsiderojmë se janë të gabuara mendimet e shkencëtarëve të ndryshëm të botës e shqiptarë që e lidhin me dardhat dhe me Dardaniën e Frigjisë, dhe jo të shjegojnë se prej Dardanisë sonë janë nisur udhëtimet apo ekspeditat drejt Lindjes e deri në Indi, duke e shfrytëzuar territorin e sotëm të Greqisë. Gjuha e parë simbolike ka qenë gjuha e parë e Europës, e filluar nga Gadishulli Ilirik, i cili është në studim të përhershëm dhe i ka më shumë se 200 shenja sakrale, sepse njeriu i këtyre zonave të hershme u drejtohej perëndive, pra Njeriu-Shkrimi-Zoti qenë aty, prej fillimit të tyre.¹³

1.2 ALFABETI DIELLOR

Alfabeti diellor i zë vitet e para, prej 25, 000 e deri në vitin 1707 p.e.s., kur ka ndodhur përmytja e fundit e madhe¹⁴. Por, po të logaritët shkrimi simbolik i ilirëve të Gadishullit Ilirik, i cili është dokumentuar në mes të viteve 5300-5200 p.e.s., atëherë shkrimi diellor është shkrimi simbolik, i cili është 200 vite përpara shkrimit sumerik. Edhe shkrimi sumerik është një shkrim iliro-pellazg i Lindjes. Meqë ata sytë i drejtonin nga Yjet e Dielli, e prireshin vetëm nga Yjet, ndërsa veten e quanin Yllir/Ilir/Hyllir, të cilët pseudoshkenca dhe shkenca e verbuar nuk i njeh, d.m.th. nuk i ka studiuar si të tillë. Ne, e quajmë “Alfabeti diellor”, si Xhemajl Gashi e Besir Bajrami.¹⁵ Të mos e harrojmë se pjesa më e madhe e Europës e ka origjinën e vet prej Polifemit, të martuar me Galatenë, i cili i ka lënë tre djemë: Ilirin, Galin e Keltin, prej të cilëve janë themeluesit e kontinentit. Gjeneratën e Polifemit e kanë quajtur mbinjerëz, hyjni, me trup shumë më të lartë se sa njeriu i ynë, ndërsa gjeneratat tjera i kanë quajtur gjysmë-hyjni. Në atë kohë njeriu ka qenë shumë më i besueshëm në të panjohurën, në formën e besimit, dhe nuk ka qenë aspak materialist. Bota ka qenë e ndarë në Lindje e Perëndim dhe nuk është sa duhet “e njohur” për ne. Qytetërimi njerëzor ka filluar prej Ciklopit lab (nga Labëria, Shqipëri), me emrin Polifem dhe janë prirur prej Yjeve. Nuk kanë pasur njohuri tjetër dhe janë quajtur Yllirët/Hyllirët. Mjaft dijetarë i quajnë pellazgë, pjellargë, pjellëbardhë, etj. pra ata mbesin nën prizmin e ideologjisë greko-shqiptare, të shkruar me alfabetin fenikas.

Popullatat në zhvillim e sipër janë të titulluara me emrin pellazgo-illire. Në të folurën e përditshme e kanë përdorur shqipen. Shqipja, shqiponja janë më të shenjatat. Se si jetonte në tokë njeriu e përcjellnin shqiponjat te Hyjniu. Të gjithë provoheshin me gjëra të jetës e konsideroheshin se janë “të ardhur prej

¹¹ Po aty, faqe 334.

¹² Shikoni më tutje në mbështetje të këtij mendimi, te „Kosova Arkeologjie“.

¹³ Shikoni po deshtë të libri i studimeve të Agron Jahës, “Teoria Ilire/Filozofia historike e korpusit kulturor ilir”, Burlage, Münster/D 2014, faqe 19.

¹⁴ Shikoni librin historik të Prof. Dr. Eqrem M. Zenelaj, „Pellazget-ilirët-shqiptarët...“, faqe 31.

¹⁵ Shikoni faqen e Besir Bajramit, në <http://www.facebook.com/besir.bajrami>, të marruna prej Xhemajl Gashit.

Yjeve". Për t'a shpjeguar më bindshëm origjinën e tyre, janë mitologjitë. Prejardhja e tyre ishte "*hyjnore*". Pra, lidheshin me Zotat. Fiset ilire (yllire) kanë qenë fiset më të zgjedhura dhe popullata më e madhe apo më e përhapur në Europë. Aty vinë galët, keltët, ilirët (*e këtu, të gjithë: arbërit, albanët, arbanët, arbëreshët, avrenjanët, apo arnautët, etj.*), të cilët janë të racës ariane dhe quhet raca e bardhë apo europiane, e cila është ngjyrë ari, e artë. Ata janë quajtur prej vëllaut të tretë të Ilirit, Keltit "albanë (shqiptarë)", të cilët e krijuan alfabetin e parë simbolik, AL-B(e)-ANË, ana nga e cila janë krijuar shkronjat e para, ALB, prandaj është alfabeti Diellor (*te dardanët e dytë të Turqisë*) apo simbolik (*te dardanët e parë, në Gadishullin Maia apo Ilirik*). Në këtë shembull quhen "Schwäbische ALB", në Hallstatt/D, dhe ALBA-LONGA në Romë/IT, të cilët i ka krijuar populli i vjetër Yllir, e askush tjetër, pra shqipfolësit, prej SHQIPES.

Albanët e vjetër kanë qenë albanët e Trojës. Popullsia Trojane ka qenë dardano-albane. Faktet që tregojnë këtë punë nga gjurmimet arkeologjike e deri në të dhënat e historisë e të historianëve antikë, popullsia e Azisë së Vogël është direkt i fisit ilir, të mbiquajtur dardano-albane.¹⁶ E rikujtojmë edhe njëherë se trekëndëshi më i pastër për themelimin e gjuhës shqipe merret trekëndëshi NISH-SOFJE-SHKUP. Studiuesja maqedonase Fanula Papazoglu, thotë sipas veprës së Sulejman Matos "*Vëzhgime mbi lashtësinë e Gjuhës Shqipe*",¹⁷ se "*dardania paraqitet si një nga rajonet ballkanike më pa të romanizuara*", ndërsa gjuhëtari i njohur i albanologjisë, Prof. Dr. Eqrem Çabej, dardaninë e ka quajtur si "*pjesë e trevës gjuhësore dhe më të kryehershme të shqipes*".¹⁸ Ky gadishull, që është quajtur "MAIA", pra vend me maja dhe i lartë; është quajtur YLL-YLLIRI, simbol i Diellit. Prej kësaj e lidhim edhe SHQIPEN, prej emrit SHQIPONJË; prej YLLIT më të zjarrtë-DIELLIN; dhe në këto baza e kemi YLLIR-ILIR, IPHEST-STIPHE-SHQIPE, IPE-SHQ/IPE, gjuhën mëmë të Europës e të tërë botës, pra gjuhën shqipe.¹⁹ Jokli arrin në përfundimin e vet se djepi i lashtë i shqiptaro-ilirëve ka qenë Dardania, në Gadishullin Ilirik (*Hemi, Maia, Ballkani*), ndërsa dijetari francez E. Pitar, piketon dy tiparet kryesore të iliro-shqiptarëve, flokët dhe irisin e syrit, të cilat mbizotërojnë te të dy gjinitë (mashkullore e femërore), ngjyra kafe e irisit, që është mbi 70 për qind të rasteve të studiuar, dhe ngjyra blu e syve, e cila është nga pak e hapur.²⁰

Në këtë diskutim ndërlidhen disa mendimtarë, pro e kontra. Po e marrim në këtë rast Nezir Shalën, në të cilën thuhet se TIRAS ishte djali i shtatë i Jafetit (*Japhetit; e Japheti ishte djali i parë i Noas, i Nuhës/Nuhit. Këta emra janë emra tradicional të shqiptarëve, pra mos e harroni këtë emër, në të tri format: Noa, Nuhi dhe Nuha!*). Japfeti, thuhet në sqarim se e kishte në ponësi Europën.²¹ Kjo thënie na e hedh syrin nëpër tërë kontinentin. Ai e lidhë në versionin anglisht me Japheth's-International Standard Version. Kur ta shikojmë

¹⁶ Shikoni shkrimin e datës 22 korrik 2017, "*Trojanët ishin iliro-dardan*", në Gazeta Info Press, në http://www.gazetainfopress.com/historia_arkeologji/trojanet-ishin-iliro-dardan.

¹⁷ Te Sulejman Mato mund të bëhet një sugjerim, se asnjë nga veprat që ka nxjerrë citate nuk është sqaruar me fusnota se cilat janë këto vepra, prej cilës faqe janë nxjerrë këto thënie, prej cilës shtëpi botuese, në cilin vit e në cilin vend janë botuar ato. Këtë vërejtje mund ta bartë mbi vete Sulejman Mato, por edhe botuesit e dy veprave të tij. Ne po e themi më tutje faqet e librit të Sulejmon Matos, prej të cilit janë nxjerrë këto thënie...

¹⁸ Sulejman Mato, "*Vëzhgime mbi lashtësinë e Gjuhës shqipe*", pa shtëpi botuese, Tiranë 2015, faqe 75.

¹⁹ Mili Butka (Aleksander Hasanas), "*Kodi i gjuhës shqipe/Etimologji*", Magus, Tiranë 2017, faqe, 205.

²⁰ Prapë vepra e Sulejmon Matos, "*Vëzhgime mbi lashtësinë...*", faqe 76.

²¹ Shikoni po deshët librin Kastriot Melyshit, "*Shqipja dhe e vërteta Biblike*", GEER, Tiranë 2014, faqe 20.

²¹ Shikoni provën e parë, sepse ka edhe të tjera, librin e Fredi Balajt, "*Gjuha që bota e flet dhe simbolika e germave*", FRAL 2000, Tiranë 2017.

²¹ Vepra e Kastriot Melyshit, e cekur më lartë, faqe 8.

²¹ Shikoni shkrimin e vënë në "*Kosovas Arkeologie*", të datës 12 dhjetor 2018, "*Misteret e Dardanisë antike <<Dardania e pazbuluar>>, historia antike shqiptare*", në http://www.facebook.com/Kosovas_Arkeologie.

²¹ Shikoni në veprën e Zef Mirditës, "*Studime Dadane*", Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982, sipas F. Papazoglu, ZEF VIII-1 (1964), 73, në faqen 29.²¹ Shikoni po aty, te Aleksander Hasanas, në profilin personal të FB, të datës 13.11.2019, mbi etrusket dhe shikoni Nezir Shalën, të lidhur në diskutime, në <http://www.facebook.com/aleksander.hasanas>.

të tërën, duke mos e harruar thënien lapidare të Spiro Kondës, po e themi se gjuha shqipe bënë pjesë në bashkëfisërinë (homoethinë) japetike, të Japfetit, sepse lindja e saj është trekëndëshi Nish-Sofje-Shkup. Kosova sot zë një vend kyq të Dardanisë së vjetër dhe është e banuar prej shqiptarëve iliro-dardanë. Dr. Elena Kocaqi e shpjegon se emërtimi i Kosovës është me prejardhje sllave, siç e bënë të ditur edhe Arif Matit (Aref Mathieu), për të argumentuar përpjekjet sllave, që kanë qenë në betejën e Kosovës, në mbulimin e identitetit të lashtë shqiptar të Dardanisë, treva më gjallë e ilirisë, të cilët e festojnë si "fitore" humbjen apo disfatën, me datën 15 qershor 1389 (kalenderi julian), dhe vendin ku kanë luftur ata, të prirë nga shqiptaro-ilirët, e cila quhej "*fusha e mëllenjave*".²² Mëllenjat janë të zeza, që simbolikisht e japin këtë disfatë, sidomos për serbo-sllavët dhe të tjerët, jo për iliro-dardanët dhe të gjithë ilirët.

Elena Kocaqi e Arif Mati, dhe mjaft të tjerë, thonë se ky emër duhet të ndërrohet. "*Emri Kosovë është një emër sllav që u vendos kahinës shqiptare Dardane, nga Osmanët me insistimin rus në emër të pansllavizmit, në fillim të shekullit të XIX...*".²³ Emri "Kosovo", paralelisht me adoptimin shqip "Kosovë", është pikërisht në këto shtete sllave: Rusia e Bardhë: "Kosovo"; Bosnja dhe Hercegovina: "Kosova"; Bulgaria: "Kosov", "Kosovo" = 3 vende; Kroatia: "Kosovo"; Republika Çeke: "Kosov", "Kosova Hora"; Estonia: "Kosova"; Maqedonia: "Dolno Kosovrasti", "Kosovo"; Polonia: "Kosów Lacki"; Rusia: i ka kater vende "Kosov", "Kosovka", "Kosovo"; Slovakia: "KoKošovce"; Slovenia: "Kosovo", e në të cilën Lublana e ka edhe "Kosovo Polje; Ukraina: "Kosov", "Kosovka", "Kosovscyna", etj.²⁴ Këto emërtime përdoren sot për vend e vendbanime sllave. Prandaj, si i tillë, nuk është i denjë ky emër për 80% të shqiptarëve në të sotmen Kosovë. Për këtë arsye, ai duhet të ndërrohet...

2. PËRFUNDIME

- Emri "Kosovë", duhet të ndërrohet, sepse është emërtimi i Kosovës është me prejardhje sllave, nuk është i denjë ky emër për 80% të shqiptarëve në të sotmen Kosovë.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

1. Vepra e Zef Mirditës, "*Studime Dadane*", Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982, sipas F. Papazoglu, ZEF VIII-1 (1964), 73, në faqen 29.
2. Kastriot Melyshit, "*Shqipja dhe e vërteta Biblike*", GEER, Tiranë 2014, faqe 20.
3. Fredi Balaj, "*Gjuha që bota e flet dhe simbolika e germave*", FRAL 2000, Tiranë 2017.
4. "*Kosovas Arkeologie*", të datës 12 dhjetor 2018, "*Misteret e Dardanisë antike <<Dardania e pazbuluar>>, historia antike shqiptare*", në <http://www.facebook.com/KosovasArkeologie>.
5. Zef Mirdita, "*Studime Dadane*", Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982, sipas F. Papazoglu, ZEF VIII-1 (1964), 73, në faqen 29.
6. Prof. Dr. Eqrem M. Zemelaj, "*Pelazgët, ilirët, shqiptarët/Historiografia e lashtësisë dhe vazhdimësisë së një populli pro selenë-Burime arkivore të vendeve të huaja*", Botimet Artini, Prishtinë 2017, faqe 339-340.

²² Shikoni punimin e Arif Matit, në gazetën elektronike "*Një Komb*", "*Emri Kosovë i krijuar nga serbët/duhet të ndërrohet*", me 5 nëntor 2018, në <http://www.njekomb.com/?p=152828>.

²³ Shikoni Elena Kocaqin në referendumin për ndërrimin e emrit Kosovë, "*Referendumi për ndryshimit të emrit të Kosovës. Qytetarët: të quhet Dardani*", me 20 janar 2019, <http://www.qazetatema.net/2019/01/20/referendum-per-ndryshimin-e-emrit-te-kosoves-qytetarët-te-quhet-dardani>.

²⁴ Shikoni profilin e Elena Kocaqit, prej të cilit i kam marrë disa të dhëna dhe jam bashkuar me te, në FB, me datën 17 shkurt 2018, në <http://facebook.com/elena.kocaqi>.

7. Agron Jaha, *"Teoria Ilire/Filozofia historike e korpusit kulturor ilir"*, Burlage, Münster/D 2014, faqe 19.
8. Prof. Dr. Eqrem M. Zenelaj, *"Pellazget-ilirët-shqiptarët..."*, faqe 31.
9. Besir Bajrami, në <http://www.facebook.com/besir.bajrami>, të marruna prej Xhemajl Gashit.
10. Shkrimi i datës 22 korrik 2017, *"Trojanët ishin iliro-dardan"*, në Gazeta Info Press, në http://www.gazetainfopress.com/historia_arkeologji/trojanet-ishin-iliro-dardan.
11. Sulejman Mato, *"Vëzhgime mbi lashtësinë e Gjuhës shqipe"*, pa shtëpi botuese, Tiranë 2015, faqe 75.
12. Mili Butka (Aleksander Hasanas), *"Kodi i gjuhës shqipe/Etimologji"*, Magus, Tiranë 2017, faqe, 205.
13. Prapë vepra e Sulejmon Matos, *"Vëzhgime mbi lashtësinë..."*, faqe 76.
14. Kastriot Melyshi, *"Shqipja dhe e vërteta Biblike"*, GEER , Tiranë 2014, faqe 20.
15. Shikoni shkrimin e vënë në *"Kosovas Arkeologie"*, të datës 12 dhjetor 2018, *"Misteret e Dardanisë antike <<Dardania e pazbuluar>>, historia antike shqiptare"*, në <http://www.facebook.com/Kosovas> Arkeologie.
16. Shikoni në veprën e Zef Mirditës, *"Studime Dadane"*, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë 1982, sipas F. Papazoglu, ZEF VIII-1 (1964), 73, në faqen 29.¹ Shikoni po aty, te Aleksander Hasanas, në profilin personal të FB, të datës 13.11.2019, mbi etrusket dhe shikoni Nezir Shalën, të lidhur në diskutime, në <http://www.facebook.com/aleksander.hasanas>.
17. Arif Mati, në gazetën elektronike "Një Komb", *"Emri Kosovë i krijuar nga serbët/duhet të ndërrohet"*, me 5 nëntor 2018, në <http://www.njekomb.com/?p=152828>.
18. Elena Kocaqin në referendumin për ndërrimin e emrit Kosovë, "Referendumi për ndryshimit të emrit të Kosovës. Qytetarët: të quhet Dardani", me 20 janar 2019, <http://www.gazetatema.net/2019/01/20/referendum-per-ndryshimin-e-emrit-te-kosoves-qytetaret-te-quhet-dardani>.